

Aneksi 7

FTESË PËR OFERTË

Emri: Instituti për Politika Zhvillimore INDEP
Adresa: Rr. ‘Fehmi Agani’, Nr. 50 A/4
Kodi Postar 10000, Prishtinë, Kosovë
E-mail: office@indep.info
Afati i dorëzimit të ofertës: 24 Gusht 2024

Instituti për Politika Zhvillimore INDEP po zbaton projektin “*Të rinjtë për një të ardhme të qendrueshme*” në kuadër të Programit Rajonal për Demokracinë Vendore në Ballkanin Prendimor 2 (ReLOaD2), i cili financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), duke mbështetur bashkitë në zhvillimin e mekanizmave transparente të financimit për OSHC-të, në mënyrë që të përmirësojë ofrimin e shërbimeve për qytetarët në komunitetin lokal.

Kushtet për pjesëmarrje:

Të gjithë subjektet e interesuara duhet të dorëzojnë ofertën e tyre sikurse parashikohet në kushtet e përgjithshme dhe specifike të kësaj ftese, më së largu deri më 24 Gusht 2024, në adresën e e-mailit: office@indep.info ose në adresën postare Rr. ‘Fehmi Agani’, Nr. 50 A/4, Kodi Postar 10000, Prishtinë, Kosovë. Ofertat e pranura pas këtij afati, konsiderohen të pavlefshme.

Specifikimet teknike:

Për këtë projekt, Instituti për Politika Zhvillimore INDEP do të zhvillojë procedurën e prokurimit për produktin sipas përshkrimeve në tabelën e mëposhtme.

Nr	Përshkrimi i produktit	Ditë pune	Çmimi/njësi Me TVSH (EURO)
1.	Ekspert për prodhimin e një video promovuese	3	
	Totali		

Specifikime të përgjithshme teknike:

- Eksperti do të jetë i angazhuar për ofrimin e shërbimit gjatë 3 ditëve përgjatë periudhës **1 shtator – 1 nëntor 2024 (1 ditë intervista me 4-5 akterë të projektit dhe imazhe të aktiviteteve të realizuara në Komunën e Fushë Kosovës, 1 ditë filmim i aktivitetit të ndarjes së mbeturinave në Komunën e Fushë Kosovës, 1 ditë montazhim)**
- Përgatitja nga ana e ekspertit të Skenarit dhe Planifikimit të Detajuar duke përfshirë edhe materialet e ndara nga ana e organizatës
- Të hartoj elementët kryesor që do të përfshihen në filmim
- Video duhet të ketë cilësi të lartë dhe një kohëzgjatje prej 2-4 minuta
- Video duhet të dorëzohet si mp4 file me cilësi të lartë pas miratimit nga ana e organizatës
- Me Subjektin fitues do të lidhet nje kontrate.

Kushte të përgjithshme:

- 1) Minimum 3 vite eksperiencë në filmim dhe redaktim
 - 2) Të jetë në gjendje të ofroj ide kreative për prodhimin e videos
 - 3) Të ketë aftësi për të zhvilluar një skenar të mire strukturuar dhe tërheqës
 - 4) Eksperiencë në përgatitjen e Mesazheve/spoteve/videove me natyrë mjedisore/kulturore
 - 5) Preferohet person fizik që ushtrojnë ekspertizën e tyre në territorin e Komunës së Fushë Kosovës;
 - 6) Eksperti në ofertën e paraqitur duhet të ketë të përfshirë të gjitha kostot teknike dhe logjistike (transport, etj)
 - 7) Dorëzimi i ofertës do të bëhet vetëm nëpërmjet email office@indep.info brenda datës 24 Gusht 2024 ose në adresën postare Rr. ‘Fehmi Agani’, Nr. 50 A/4, Kodi Postar 10000, Prishtinë, Kosovë.
- Nuk pranohen ofertat dorazi.**
- 8) PAGESA E subjektit/ personit fizik kryhet me transfertë bankare pas marrjes së shërbimit dhe lëshimit të faturës përkatëse ose subjekt i tatimit mbi të ardhurat 18% e cila do të zbritet si një tatim në burim.

Në ofertën e tij, ofertuesi duhet të paraqesë të dhënat e plota të personit të kontaktit. Gjithashtu ofertuesit, krahas Ofertës financiare të plotësuar, e cila duhet të jetë në EURO , me TVSH të përfshirë në çmim, por gjithashtu edhe me vlerë pa TVSH, duhet të paraqesin edhe këto dokumenta:

- 1) CV ku te tregohen eksperiencat e mëparshme;
- 2) Çertifikatë Regjistrimi nga ARBK në rastin kur është subjekt, ose ID në rastin e personit fizik;
- 3) Ofertën financiare për produktin sipas tabelës më sipër;
- 4) Numrin e llogarisë bankare.

Operatori që ofron shërbimin me çmimin më të ulët dhe në përputhje me specifikimet teknike sipas ftesës, do të njoftohet për të nënshkruar kontratën.